



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 56

2003

Korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.426, datë 26.6.2003	Për miratimin e rregullave teknike, në zbatim të udhëzimeve nr.90/396/EEC dhe nr.93/68/EEC të Bashkimit Europian për futjen në treg, qarkullimin e lirë dhe vërtetimin e konformitetit të pajisjeve, që punojnë me lëndë djegëse të gazta.....	2377
Vendim i KM nr.430, datë 26.6.2003	Për revokimin e vendimit nr.74, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përdorim, pa shpërblim, të zyrave të ndërmarrjes “Makinaimpeks”, Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare”.....	2391
Vendim i KM nr.431, datë 26.6.2003	Për njësitë ligjore të matjes.....	2391
Vendim i KM nr.435, datë 26.6.2003	Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe të Hercegovinës për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës.....	2396
Vendim i KM nr.436, datë 26.6.2003	Për rritjen e pensioneve.....	2399

Vendim i KM nr.437, datë 26.6.2003	Për rritjen e shtesave mujore të pensioneve të invaliditetit, dhënë sipas vendimit nr.381, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit””.....	2400
Vendim i KM nr.438, datë 26.6.2003	Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për bashkëpunim në luftën kundër krimit.....	2400
Vendim i KM nr.440, datë 26.6.2003	Për ngritjen e Agjencisë së Urbanizimit të Zonave Informale.....	2404
Vendim i KM nr.441, datë 26.6.2003	Për një shtesë në vendimin nr.427, datë 12.9.2002 të Këshillit të Ministrave “Për njehsimin e gradave ushtarake me funksionet organike në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit dhe të drejtimit të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë”.....	2407
Vendim i KM nr.443, datë 26.6.2003	Për miratimin e strukturës e të niveleve të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës-Kanalizimeve, Institutit të Studimeve dhe Projekttimeve Urbanistike dhe Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit.....	2407
Vendim i KM nr.444, datë 26.6.2003	Për rritjen e pensioneve suplementare të ushtarakëve dhe të pensioneve dhënë familjarëve të pilotëve të rënë në krye të detyrës.....	2409
Vendim i KM nr.445, datë 26.6.2003	Për inspektimin e punës së detarëve.....	2410
Vendim i KM nr.446, datë 26.6.2003	Për disa ndryshime në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10 1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.....	2411
Vendim i KM nr.447, datë 26.6.2003	Për një ndryshim në vendimin nr.551, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.....	2412
Vendim i KM nr.448, datë 26.6.2003	Për një shtesë në vendimin nr.775, datë 28.10.1996 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Ujit”, i ndryshuar.....	2413

V E N D I M
Nr.426, datë 26.6.2003

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE, NË ZBATIM TË UDHËZIMEVE NR.90/396/EEC DHE NR.93/68/EEC TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR FUTJEN NË TREG, QARKULLIMIN E LIRË DHE VËRTETIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE, QË PUNOJNË ME LËNDË DJEGËSE TË GAZTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e rregullave teknike, në zbatim të udhëzimeve nr.90/396/EEC dhe nr.93/68/EEC të Bashkimit Europian për futjen në treg, qarkullimin e lirë dhe vërtetimin e konformitetit të pajisjeve, që punojnë me lëndë djegëse të gazta, sipas materialit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RELACIONI I PËRPUTHSHMËRISË

Për vënien në zbatim të direktivës 90/396/EEC amenduar me 93/68/EEC “Pajisjet me lëndë djegëse të gazta” në legjislacionin shqiptar (Sipas Metodologjisë përafruese të hartuar nga Ministria e Drejtësisë)

Dispozitat e projektit	Përshkrimi	Dispozitat e direktivës	Shënim
Kreu I			
Fusha e zbatimit, futja në treg dhe qarkullimi i lirë			
1.1	Fusha e zbatimit	1.1	
1.2	Përgjashtuar nga fusha e zbatimit	1.2	
1.3	Përkufizimi “lëndë djegëse e gaztë”	1.3	
1.4	Përkufizimi “e përdorur normalisht”	1.4	
2.1	Futja në treg dhe vënia në shfrytëzim	2.1	
2.2	Informimi për tipat e gazeve të përdorura	2.2	
3	Kërkesat thelbësore	3	
4.1	Futja në treg dhe vënia në shfrytëzim e pajisjeve që plotësojnë kërkesat thelbësore	4.1	
4.2	Futja në treg e pajisjeve të pajisura me certifikatë	4.2	
5.1	Përputhja me kërkesat thelbësore	5.1	
6	Klauzolë mbrojtëse për heqjen nga tregu dhe ndalimin e futjes në treg të pajisjeve që rrezikojnë sigurinë	7	
Kreu II			
Procedurat për vërtetimin e konformitetit			
7.1	Procedurat e vërtetimit të konformitetit të pajisjeve të prodhuara në seri	8.1	
7.2	Rasti i prodhimit të një ekzemplari të vetëm ose në sasi të vogël	8.2	

7.3	Vendosja e shenjës “CE” të konformitetit	8.3
7.4	Procedurat që lidhen me dispozitivët	8.4
7.5	Vendosja e shenjës “CE” të pajisjeve që mbulohen edhe nga direktiva të tjera	8.5
7.6	Gjuha e përdorur në fashikujt dhe korrespondencën lidhur me mjetet e vërtetimit të konformitetit	8.6
8.1	Organizmat e notifikuar	9.1
8.2	Kriteret për miratimin e organizmave të notifikuar	9.2
8.3	Revokimi i miratimit	9.3
Kreu III		
Marka e konformitetit CE		
9.1	Vendosja e markës së konformitetit “CE”	10.1
9.2	Ndalimi i vendosjes së markave të tjera	10.2
10	Masat për rastin kur marka CE është vendosur gabim	11
Kreu IV		
Dispozita të fundit		
11	Vendimet që sjellin kufizime për futjen në treg	12
12	Zhdoganimi dhe doganimi	
Lidhjet		
Lidhja 1	Kërkesat thelbësore	Lidhja I
Lidhja II	Procedurat e vërtetimit të konformitetit	Lidhja II
1	Shqyrtimi i tipit	1
2	Deklarimi i konformitetit me tipin	2
3	Deklarimi i konformitetit me tipin (Garantimi i cilësisë së prodhimit)	3
4	Deklarimi i konformitetit me tipin (Garantimi i cilësisë së produktit)	4
5	Verifikimi	5
6	Verifikimi i një produkti të vetëm	6
Lidhja III	Shënimi CE i konformitetit dhe mbishkrimet	Lidhja III
Lidhja IV	Dokumentacioni lidhur me projektimin	Lidhja IV
Lidhja V	Kriteret minimale për vlerësimin e organizmave të miratuar dhe të notifikuar	Lidhja V

RREGULLA

TEKNIKE PËR FUTJEN NË TREG, QARKULLIMIN E LIRË DHE VËRTETIMIN E KONFORMITETIT PËR PAJISJET ME LËNDË DJEGËSE TË GAZTA

KREU I FUSHA E ZBATIMIT, FUTJA NË TREG DHE QARKULLIMI I LIRË

Neni 1

1. Këto rregulla zbatohen në:
 - Pajisjet që përdoren për gatimin, ngrohjen, prodhimin e ujit të ngrohtë, ftohjen, ndriçimin dhe larjen, që djegin lëndë djegëse të gazta dhe kanë, po të jetë e nevojshme, një temperaturë normale të ujit jo më të lartë se 1050 C, të quajtura në vazhdim “Pajisje”. Përfshihen në pajisjet djegësit me ajër të fryrë dhe shkëmbyesit e nxehtësisë të pajisur me djegësit e sipërpërmendur.
 - Dispozitivët e sigurisë, të kontrollit e të rregullimit dhe nëngrupet, të ndryshme nga djegësit e me ajër të fryrë nga trupat e shkëmbimit të nxehtësisë të pajisur me përfuesit e sipërpërmendur, që tregtohen në mënyrë të veçantë për t’u përdorur nga profesionistë dhe të destinuara për t’u përfshirë në një pajisje me gaz ose të montuara për të ndërtuar një pajisje me gaz, të emëruar në vazhdim “Dispozitivë”.
2. Përfshihen nga fusha e zbatimit, e përcaktuar në paragrafin 1 pajisjet e destinuara që përdoren vetëm në procese industriale në ndërmartje industriale.
3. Në këto rregulla teknike, për “lëndë djegëse të gazta” kuptohet çfarëdo lëndë djegëse që në një temperaturë 150 C dhe në një presion 1 bar është në gjendje të gaztë.
4. Në këto rregulla teknike një pajisje konsiderohet “e përdorur normalisht” kur:
 - është instaluar pa gabime dhe i është nënshtuar mirëmbajtjes së rregullt në përputhje me udhëzimet e prodhuesit;
 - është përdorur në fushën normale të ndryshimit të vetive të gazit dhe të presionit të ushqimit;
 - është përdorur për qëllimet për të cilat është ndërtuar ose në mënyra të parashikueshme me arsyë.

Neni 2

1. Lejohet futja në treg dhe vënia në shfrytëzim e pajisjeve me lëndë djegëse të gazta vetëm nëse, kur përdoren normalisht, nuk vënë në rrezik sigurinë e njerëzve, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve u bën të njohur furnizuesve të interesuar të pajisjeve me lëndë djegëse të gazta, tipat e gazeve të përdorura në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe presionet përkatëse të ushqimit. Gjithashtu bën të njohur në çdo kohë për çdo ndryshim.

Neni 3

Pajisjet dhe dispozitivët e nenit 1 duhet të plotësojnë kërkesat thelbësore të zbatueshme për to dhe që paraqiten në lidhjen 1.

Neni 4

1. Nuk mund të ndalohet e të kufizohet ose të pengohet futja në treg dhe vënia në shfrytëzim e pajisjeve, që janë në përputhje me të gjitha dispozitat e këtij vendimi, duke përfshirë edhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të formuluar në kreun II dhe mbajtjen e shenjës CE të parashikuar në nenin 10.
2. Nuk mund të ndalohet, të kufizohet ose të pengohet futja në treg e dispozitivëve të nenit 1, të pajisur me certifikatë sipas nenit 8 të paragrafit 4.

Neni 5

1. Prezumohen në përputhje me kërkesat thelbësore të nenit 3 pajisjet dhe dispozitivët që përputhen:
 - a) Me standardet shqiptare përkatëse dhe që adaptojnë standardet ndërkombëtare ISO dhe standardet europiane të harmonizuara. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit boton referimet e

këtyre standardeve.

b) Me standardet shqiptare përkatëse, kur në sektorin e mbuluar nga këto standarde shqiptare nuk ekzistojnë standarde të harmonizuara.

Neni 6

Në rastin kur disa pajisje që janë përdorur normalisht mund të vënë në rrezik sigurinë e njerëzve, të kafshëve shtëpiake ose vlerave materiale, Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës merr të gjitha masat e nevojshme për heqjen e këtyre pajisjeve nga tregu ose për të ndaluar ose kufizuar futjen e tyre në treg.

KREU II PROCEDURAT PËR VËRTETIMIN E KONFORMITETIT

Neni 7

1. Procedurat për vërtetimin e konformitetit të pajisjeve të prodhuara në seri janë si vijojnë:
 - a) Shqyrtimi i tipit të parashikuar në lidhjen II pika 1;
 - b) Para futjes në treg, sipas zgjedhjes së prodhuesit;
 - deklarimi i konformitetit me tipin, i parashikuar në lidhjen II pika 2;
 - deklarimi i konformitetit me tipin (garantimi i cilësisë së prodhimit) i parashikuar në lidhjen II pika 3;
 - deklarimi i konformitetit me tipin (garantimi i cilësisë së produktit) të parashikuar në lidhjen II pika 4;
 - verifikimi i parashikuar në lidhjen II pika 5.
 - c) Procedurat e vërtetimit të konformitetit të lidhjes II të zbatohen në mënyrë që të garantohet plotësimi i kërkesave thelbësore të nenit 3 dhe që t'u jepet mundësi hyrjeje furnizuesve të pajisjeve të prodhuara në vend dhe me origjinë nga territori i vendeve anëtare të OBT-së. Hyrje nënkupton të drejtën e furnizuesve për vlerësimin e konformitetit përfshirë mundësinë për të zhvilluar aktivitetet për vlerësimin e konformitetit tek prodhuesi, si dhe mundësinë e marrjes së markës së konformitetit.
2. Në rastin e një pajisjeje të prodhuar si ekzemplar i vetëm ose në sasi të vogël, prodhuesi mund të përdorë verifikimin e ekzemplarit të vetëm të parashikuar në lidhjen II pika 6.
3. Pas përfundimit të procedurave të paragrafit 1 gërma (b) dhe të paragrafit 2, mbi pajisjet konform të prodhuara në vendet e Bashkimit Europian ose nga prodhues që kanë përfaqësues të stabilizuar në komunitet, vendoset shenja CE sipas rregullave të vendosura në nenin 9.
4. Për dispozitivët e parashikuar në nenin 1 zbatohen procedurat e paragrafit 1, me përjashtim të vendosjes së shenjës CE dhe sipas rastit përpilimi i deklaratës së konformitetit. Lëshohet një certifikatë në të cilën deklarohet konformiteti i dispozitivëve me kërkesat përkatëse të këtij vendimi dhe jepen karakteristikat e dispozitivëve. Jepen në të gjithashtu kushtet e përfshirjes në pajisje ose të montimit që kontribuojnë në plotësimin e kërkesave thelbësore që zbatohen në pajisjet e përfunduara. Certifikata jepet së bashku me dispozitivin.
- 5.a) Kur pajisjet mbulohen nga direktiva të tjera që krahas aspekteve të tjera merren me specifikimin e vendosjes së shenjës CE, kjo e fundit tregon se pajisjet prezumohen konform me kërkesat e këtyre direktivave.
 - b) Megjithatë, nëse një ose disa nga këto direktiva e lejojnë prodhuesin që për një periudhë kalimtare të zgjedhë rregullat që do të zbatojë, shënimi Ce tregon konformitetin vetëm me dispozitat e direktivave të zbatuara. Në këtë rast të dhënat për direktivat e zbatuara, jepen në dokumentet, njoftimet ose udhëzimet që shoqërojnë pajisjet.
6. Fashikujt dhe korrespondenca lidhur me mjetet e vërtetimit të konformitetit përpilohen në gjuhën e shtetit në të cilën është stabilizuar organizimi i ngarkuar me kryerjen e këtyre procedurave ose në një gjuhë të pranuar nga ky organizëm.

Neni 8

1. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës miraton organizmat që kryejnë procedurat e

vlerësimit të konformitetit. Kur procedurat e referuara në nenin 7 u ngarkohen organizmave të notifikuar të vendeve anëtare të Bashkimit European, lista e këtyre organizmave dhe numrat e identifikimit janë të botuara nga komisioni në Gazetën Zyrtare të Komunitetit European.

2. Për vlerësimin e organizmave që do të miratohen, zbatohen kriteret e vendosura në lidhjen V. Organizmat, që plotësojnë kriteret e vendosura në standardet e harmonizuara, prezumohen se plotësojnë kriteret e vendosura në lidhjen V.

3. Kur organizmi i miratuar nuk plotëson më kriteret e paragrafit 2, miratimi revokohet.

KREU III MARKA E KONFORMITETIT CE

Neni 9

1. Marka e konformitetit CE, si dhe skeda e karakteristikave të treguara në lidhjen III, vendosen në mënyrë të dukshme, që të mund të lexohen lehtë dhe në mënyrë të pafshirshme mbi pajisje ose mbi një target identifikimi të fiksuar në të. Targeta e identifikimit duhet të hartohet në mënyrë që të mos mund të ripërdoret.

2. Ndalohet vendosja e shënimeve në pajisjet që mund të ngatërrojnë palë të treta si përmbajtje dhe formë e markës CE. Pajisjes ose targetës së të dhënave mund t'i bashkëngjitet çfarëdo shënimi tjetër, me kusht që ky të mos cenojë pamjen dhe shënimin e markës CE.

Neni 10

Pa paragjykuar nenin 6:

- Kur organi kompetent vendos që shënimi CE nuk është vënë në formën e duhur, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, i vendosur në BE, duhet ta bëjë produktin të plotësojë kërkesat lidhur me shënimin CE dhe t'i japë fund shkëljes sipas kushteve të vëna nga organi kompetent.

- Nëse mosplotësimi vazhdon, organi kompetent duhet të marrë masat për të kufizuar ose ndaluar daljen në treg të pajisjes në fjalë ose të sigurojë tërheqjen e saj nga tregu, sipas procedurave të parashikuara në nenin 6.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11

Çfarëdo vendimi i marrë në zbatim të këtij vendimi, që sjell kufizime për futjen në treg ose vënien në shfrytëzim të një pajisjeje, motivohet në mënyrë të saktë. Ai i njoftohet të interesuarit me kujdesin më të madh duke i treguar mjetet ligjore të ankimit që i jep ligjshmëria në fuqi dhe afatet brenda të cilave duhet të bëhet ankimi.

Neni 12

Zhdoganimi dhe doganimi i pajisjeve me lëndë djegëse të gazta të nenit 1 bëhet pasi verifikohet dokumentacioni i parashikuar në pikën 1.2 të lidhjes I të konfirmuar nga organizmat e kontrollit, të miratuara në përputhje me kërkesat e nenit 8, si dhe certifikata e konformitetit të origjinës.

LIDHJA I KËRKESA THELBËSORE

Vërejtje paraprake.

Detyrimet që vijnë nga kërkesat e paraqitura në këtë lidhje për pajisjet zbatohen edhe për dispozitivët kur ekziston një rrezik përkatës.

1. Kushte të përgjithshme

1.1 Çdo pajisje projektohet dhe prodhohet në mënyrë që të mund të funksionojë në kushte të sigurta dhe të mos paraqesë rreziqe për njerëzit, kafshët shtëpiake dhe vlerat materiale, kur përdoret normalisht sipas përcaktimit të nenit 1 paragrafi 4 të këtij vendimi.

1.2 Pajisja e futur në treg duhet:

- të jetë e pajisur me udhëzime teknike të hartuara për instaluesin;
- të jetë e pajisur me udhëzime për përdorimin dhe mirëmbajtjen të përgatitura për përdoruesin:

- të ketë ashtu si dhe ambalazhi i saj paralajmërimet e rastit; udhëzimet dhe paralajmërimet duhet të jenë të përpiluara në gjuhën shqipe.

1.2.1 Udhëzimi teknik i hartuar për instaluesin duhet të përmbajë të gjitha udhëzimet për instalimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen, duke bërë kështu të mundur kryerjen pa gabime të këtyre punëve dhe përdorimin e sigurt të pajisjes. Udhëzimet duhet të saktësojnë në mënyrë të veçantë:

- tipin e gazit të përdorur;
- presionin e ushqimit të përdorur;
- ajrimin e lokaleve të kërkuar për;
- ushqimin me ajër për djegien;
- për evitimin e krijimit të përzierjeve me përmbajtje të rrezikshme gaz të padjegur në pajisje.

që nuk kanë dispozitivin e pikës 3.2.3 të kësaj lidhjeje;

- kushtet e largimit të produkteve të djegies;
- për djegës me ajër të fryrë dhe trupat e shkëmbimit të nxehtësisë të destinuar të pajisen me djegësit e sipërpërmendur, karakteristikat e tyre dhe kushtet e montimit që kontribuojnë në respektimin e kërkesave thelbësore të pajisjeve të përfunduara dhe nëse nevojitet, listën e kombinimeve të rekomanduara nga prodhuesi.

1.2.2 Udhëzimet për përdorimin dhe mirëmbajtjen, të hartuara për përdoruesit duhet të përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për një përdorim të sigurt dhe të tërheqin sidomos vëmendjen e përdoruesit për kufizimet në fushën e përdorimit.

1.2.3 Paralajmërimet që figurojnë mbi pajisje dhe mbi ambalazh duhet të tregojnë në mënyrë të qartë tipin e gazit, presionin e ushqimit dhe kufizimet e mundshme përsa i përket përdorimit, në veçanti kufizimin sipas të cilit pajisja duhet të instalohet vetëm në lokale të ajrosura siç duhet.

1.3 Çdo dispozitiv i destinuar të përdoret në një pajisje duhet të jetë i projektuar dhe i ndërtuar në mënyrë të tillë që të funksionojë mirë për përdorimin e destinuar, nëse montohet në përputhje me udhëzimet teknike lidhur me instalimin.

Udhëzimet lidhur me instalimin, rregullimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen duhet të furnizohen së bashku me dispozitivin.

2. Materialet

2.1 Materialet duhet të jenë të përshtatshme për përdorimin e destinuar dhe t'u qëndrojnë sforcimeve mekanike, kimike dhe termike që parashikohen t'u nënshtrohen.

2.2 Vetitë e materialeve që kanë rëndësi për sigurinë, garantohen nga prodhuesi i pajisjeve ose nga furnizuesi.

3. Projektimi dhe prodhimi

3.1 Pikëpamje të përgjithshme

3.1.1 Çdo pajisje duhet të prodhohet në mënyrë të tillë, që, kur përdoret normalisht, të mos shkaktohen paqëndrueshmëri, deformime, thyerje ose konsumime që zvogëlojnë sigurinë.

3.1.2 Kondensimi i prodhuar në ndezje, si dhe gjatë funksionimit nuk duhet të zvogëlojnë sigurinë e pajisjes.

3.1.3 Çdo pajisje duhet të konceptohet dhe të prodhohet në mënyrë të tillë që rreziku i shpërthimit në rast zjarri me origjinë të jashtme të zvogëlohet në minimum.

3.1.4 Pajisja duhet të prodhohet në mënyrë të tillë që të shmangen depërtimet e ujit dhe të ajrit parazitarr në qarkun e gazit.

3.1.5 Pajisja duhet të vazhdojë të funksionojë në kushte sigurie edhe në rastin e një luhatjeje normale të energjisë ndihmëse.

3.1.6 Një luhatje me anomali ose një ndërprerje e ushqimit të energjisë ndihmëse ose rifillimi i saj nuk duhet të paraqesin një burim rreziku.

3.1.7 Çdo pajisje duhet të projektohet dhe të ndërtohet në mënyrë të tillë që të parandalojë

rreziqet me origjinë elektrike. Në sektorin e saj të zbatimit prezumohet konformiteti me këtë kërkesë, kur respektohen objektivat e sigurisë lidhur me rreziqet elektrike të parashikuara në direktivën 73/23 CEE.

3.1.8 Të gjitha pjesët nën presion të një pajisjeje duhet të përballojnë sforcimet mekanike dhe termike, të cilave u nënshtrohen pa pësuar deformime, që dëmtojnë sigurinë.

3.1.9 Çdo pajisje duhet të projektohet dhe të prodhohet në mënyrë të tillë që prishja e një dispozitivi sigurie, kontrolli dhe rregullimi të mos paraqesë burim rreziku.

3.1.10 Në një pajisje të pajisur me dispozitivë sigurie dhe rregullimi, ndërhyrja e dispozitivëve të sigurisë duhet të jetë e pavarur nga funksionimi i dispozitivëve të rregullimit.

3.1.11 Të gjitha pjesët e një pajisjeje të montuara në fazën e montimit dhe të destinuara të mos manipulohen nga përdoruesi ose nga instaluesi duhet të mbrohen në mënyrë të sigurt.

3.1.12 Levat ose organet e komandimit ose të rregullimit duhet të dallohen në mënyrë të saktë dhe të kenë tregimet e duhura për të shmangur manovrime të gabuara. Ata duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të mos lejojnë manovrime të njëkohshme.

3.2 Çlirimi i gazeve të padjegura

3.2.1 Çdo pajisje duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që shkalla e rrjedhjes së gazit të mos shkaktojë ndonjë rrezik.

3.2.2 Çdo pajisje duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që rrjedhjet e gazit që ndodhin gjatë ndezjes, rindezjes dhe pas fikjes së flakës të jenë kufizuar në atë masë që të shmanget grumbullimi i rrezikshëm i gazit të padjegur në pajisje.

3.2.3 Pajisjet e destinuara, që përdoren në lokale duhet të pajisen me një dispozitiv të posaçëm, që të shmangin grumbullimin e rrezikshëm të gazit të padjegur. Pajisjet që nuk janë pajisur me një dispozitiv të tillë duhet të përdoren vetëm në lokale me ajrim të mjaftueshëm për shmangien e grumbullimit të rrezikshëm të gazit të padjegur.

Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës duke marrë parasysh karakteristikat e këtyre pajisjeve, mund të përcaktojë kushtet e mjaftueshme të ajrimit të lokaleve për instalimin e tyre.

Pajisjet për kuzhina të mëdha dhe pajisjet e ushqyera me gaz që përmbajnë përbërës helmues duhet të pajisen me këtë dispozitiv.

3.3 Ndezja

Çdo pajisje duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që, kur të përdoret normalisht:

- ndezja dhe rindezja të bëhet butë;
- të sigurohet ndezja e brendshme.

3.4 Djegia

3.4.2 Çdo pajisje të ndërtohet në mënyrë të tillë që, kur përdoret normalisht, flaka të jetë e qëndrueshme dhe produktet e djegies të mos përmbajnë përqendrime të papranueshme të lëndëve të dëmshme për shëndetin.

3.4.3 Çdo pajisje duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë, që kur përdoret normalisht, të mos prodhohen kundërmime të produkteve të djegies.

3.4.4 Pajisjet e ngrohjes së pavarur të përdorimit shtëpiak dhe ngrohësit e ujit të çastit, të palidhura me tuba shkarkimi të produkteve të djegies, nuk duhet të shkaktojnë përqendrim të monoksidit të karbonit, që mund të paraqesë rrezik të natyrës së tillë që të cenojë shëndetin e njerëzve të ekspozuar në varësi të kohës së ekspozimit të parashikuar të këtyre njerëzve.

3.5 Përdorimi racional i energjisë.

Çdo pajisje të prodhohet në mënyrë të tillë që të garantojë përdorimin racional të energjisë, i cili i përgjigjet nivelit të njohurive dhe të teknologjisë dhe mban parasysh kërkesat e sigurisë.

3.6 Temperatura

3.6.1 Pjesët e një pajisjeje të destinuara të takojnë me dyshtemenë ose me sipërfaqe të tjera, nuk duhet të arrijnë temperatura të tilla që të përbëjnë rrezik për mjedisin rrethues.

3.6.2 Temperaturat e dorezave ose levave të rregullimit të destinuara të manipulohen nuk duhet të arrijnë temperatura të tilla që të përbëjnë rrezik për përdoruesin.

3.6.3 Temperatura sipërfaqësore e pjesëve të jashtme të një pajisjeje të destinuar për përdorim shtëpiak, me përjashtim të sipërfaqeve ose të pjesëve që marrin pjesë në funksionin e transmetimit të nxehtësisë gjatë funksionimit, nuk duhet të kalojë vlerat që përbëjnë rrezik për përdoruesin e në mënyrë të veçantë për fëmijët, për të cilët duhet të merret parasysh kohë e përshtatshme reagimi.

3.7 Produktet ushqimore dhe uji për përdorim sanitar

Përveçsa kërkohet në dispozitat ligjore përkatëse, materialet dhe pjesët përbërëse të përdorura në prodhimin e një pajisjeje nuk duhet të ndryshojnë cilësinë e ushqimeve ose të ujit për përdorim sanitar me të cilët mund të bien në kontakt.

LIDHJA II PROCEDURAT E VËRTETIMIT TË KONFORMITETIT

1. Shqyrtimi i tipit

1.1 Shqyrtimi i tipit është pjesa e procedurës me të cilën organizmi i miratuar sigurohet dhe certifikon që një pajisje përfaqësuese e prodhimit të parashikuar plotëson dispozitat e direktivës përkatëse.

1.2 Kërkesat e shqyrtimit të tipit i paraqitet nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i tij, i stabilizuar në komunitet, një organizmi të vetëm të miratuar ose të njoftuar në komunitet.

1.2.1 Kërkesa përmban:

- emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i tij, emrin dhe adresën e këtij të fundit;

- një deklaratë të shkruar që specifikon se kërkesa nuk i është paraqitur asnjë organizmi tjetër kontrolli;

- dokumentacionin lidhur me projektin, siç tregohet në lidhjen IV.

1.2.2 Kërkesi vë në dispozicion të organizmit të miratuar një pajisje përfaqësuese të prodhimit të parashikuar, që do të quhet në vazhdim “tip”. Organizmi i kontrollit mund të kërkojë ekzemplarë të tjerë të tipit, nëse është e nevojshme për programin e provës.

Tipi mund të përmbajë edhe variante të produktit, me kusht që karakteristikat e këtyre varianteve të mos ndryshojnë përse i përket tipit të rrezikut.

1.3 Organizmi i miratuar ose i notifikuar

1.3.1 Shqyrton dokumentacionin lidhur me projektin, verifikon nëse tipi është prodhuar në përputhje me po atë dokumentacion dhe saktëson elementet e projektuara në përputhje me dispozitat e zbatueshme të standardeve sipas nenit 5 dhe të kërkesave thelbësore të parashikuara në këtë vendim.

1.3.2 Kryen ose bën të kryen shqyrtimet e duhura, si dhe provat e nevojshme për të verifikuar, nëse zgjidhjet e adaptuara nga prodhuesi i përgjigjen kërkesave thelbësore kur nuk janë zbatuar standarde sipas nenit 5.

1.3.3 Kryen ose bën të kryhen shqyrtimet e duhura, si dhe provat e nevojshme për të verifikuar, nëse standardet e zbatueshme janë zbatuar në mënyrë efikase, në rastet kur prodhuesi ka vendosur të zbatojë duke garantuar në këtë mënyrë konformitetin me kërkesat thelbësore.

1.4 Nëse tipi kënaq kërkesat e këtij vendimi, organizmi i kontrollit i lëshon kërkesit një certifikatë të shqyrtimit të tipit. Certifikata përmban konkluzionet e shqyrtimit, kushtet eventuale të vlefshmërisë dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e tipit të miratuar, si dhe, nëse është e nevojshme, përshkrimin e funksionimit. Elementet teknike përkatëse si vizatime e skema, i bashkëlidhen certifikatës.

1.5 Kur organizmi i kontrollit është i njoftuar në komunitet, ai informon menjëherë organizmat e tjerë të notifikuar për lëshimin e certifikatës së shqyrtimit të tipit dhe certifikatat shtesë të parashikuara në pikën 17. Organizmat e tjerë të notifikuar mund të marrin një kopje të certifikatës të shqyrtimit të tipit si certifikatat shtesë, dhe sipas kërkesës së motivuar, mund të marrin një kopje të lidhjeve të certifikatës, si dhe raportet lidhur me shqyrtimet dhe provat e kryera.

1.6 Një organizëm i notifikuar që refuzon të lëshojë certifikatën e shqyrtimit të tipit informon shtetin anëtar të BE-së që ka notifikuar organizmin në fjalë dhe organizmat e tjerë të notifikuar dhe saktëson shkaqet e vendimit të tij.

1.7 Kërkesi mban të informuar organizmin e miratuar që ka lëshuar certifikatën e shqyrtimit të tipit përse i përket të gjitha modifikimeve me tipin e miratuar që mund të ketë ndikim në respektimin e kërkesave thelbësore. Modifikimet e një tipi të miratuar duhet të jenë objekt i një miratimi shtesë nga ana e organizmit të miratuar, që ka lëshuar certifikatën e shqyrtimit të tipit kur këto modifikime ndikojnë në respektimin e kërkesave thelbësore ose të kushteve të përdorimit të parashikuara për pajisjen. Ky miratim shtesë merr formën e një shtojce të certifikatës origjinale të shqyrtimit të tipit.

2. Deklarimi i konformitetit me tipin

2.1 Deklarimi i konformitetit me tipin është pjesë e procedurës me të cilën prodhuesi deklaron që pajisjet në fjalë janë konform me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit të tipit dhe plotësojnë kërkesat thelbësore të zbatueshme të parashikuara në këtë vendim. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, i stabilizuar në komunitet vendos mbi secilën pajisje të destinuar për tregun komunitar shenjë "CE" dhe përpilon me shkrim një deklaratë konformiteti. Deklarata e konformitetit i përket një ose disa pajisjeve dhe ruhet nga prodhuesi. Shënimi CE duhet të pasohet nga numri i identifikimit të organizimit të notifikuar përgjegjës për kontrollin e paralajmëruara të parashikuara në pikën 2.3

2.2 Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që procesi i prodhimit, përfshirë inspektimin përfundimtar të pajisjes dhe provat, garantojnë homogjenitetin e prodhimit dhe konformitetin e pajisjeve me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit të tipit dhe të plotësojnë kërkesat thelbësore përkatëse të parashtruara në këtë rregullore. Organizmi i miratuar ose një organizëm i notifikuar i zgjedhur nga prodhuesi, kryen kontrolle të paparalajmëruara në pajisjet sipas përcaktimit në pikën 2.3.

2.3 Në intervale të paktën vjetore, organizmi i miratuar ose organizmi i notifikuar kryen kontrolle në vend pa paralajmërim të pajisjeve. Ai duhet të shqyrtojë një numër të përshtatshëm pajisjesh dhe të kryejë provat e duhura të përcaktuara në standardet përkatëse të parashikuara në nenin 5 ose prova të njëvlefshme për të sqaruar përputhjen e pajisjeve me kërkesat thelbësore përkatëse të parashtruara në këtë vendim. Organizmi i miratuar ose organizmi i notifikuar duhet të përcaktojë në çdo rast, nëse duhet të kryhen prova të plota ose të pjesshme. Nëse një ose më shumë pajisje refuzohen, organizmi merr masat e duhura për të shmangur tregimin.

3. Deklarimi i konformitetit me tipin (Garantimi i cilësisë së prodhimit)

3.1 Deklarimi i konformitetit me tipin (garantimi i cilësisë së prodhimit) është procedura me të cilën prodhuesi, që plotëson detyrimet e pikës 3.2, deklaron që pajisjet në fjalë janë konform me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit të tipit dhe plotësojnë kërkesat thelbësore të sigurisë të parashtruara në këtë vendim. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, i stabilizuar në komunitet vendos shënimin "CE" mbi çdo pajisje të destinuar për tregun komunitar dhe përpilon me shkrim një deklaratë konformiteti. Kjo deklaratë i përket një ose disa pajisjeve dhe ruhet nga prodhuesi. Shenja "CE" duhet të pasohet nga numri i identifikimit të organizmit të notifikuar përgjegjës për mbikëqyrjen.

3.2 Prodhuesi zbaton një sistem cilësie të prodhimit, i cili garanton konformitetin e pajisjeve me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit të tipit dhe me kërkesën thelbësore përkatëse të parashtruar në këtë vendim. Prodhuesi i nënshtrohet kontrollit sipas mënyrave të specifikuara në pikën 3.4.

3.3 Sistemi i cilësisë

3.3.1 Prodhuesi i paraqet një kërkesë të miratuar të sistemit të cilësisë për pajisjet në fjalë, organizmit të miratuar ose organizmit të notifikuar të zgjedhur nga ai vetë.

Kërkesa përmban:

- dokumentacionin teknik lidhur me sistemin e cilësisë;
- marrjen përsipër të plotësimit të detyrimeve që vijnë nga sistemi i cilësisë së miratuar;
- marrjen përsipër të mbajtjes të pandryshuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të cilësisë së miratuar;
- dokumentacionin lidhur me tipin e miratuar dhe një kopje të certifikatës të shqyrtimit të tipit.

3.3.2 Të gjitha elementet, kërkesat dhe masat e adaptuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formë masash, procedurash dhe udhëzimesh të shkruara. Ky dokumentacion për sistemin e cilësisë duhet të parashtrrojë një kuptim të saktë të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrimeve lidhur me cilësinë. Ai duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë një përshkrim të saktë:

- të objektivave të cilësisë, të organikës dhe përgjegjësisë të kuadrove dhe të fuqive të tyre përsa i përket cilësisë së pajisjeve;
- të proceseve të prodhimit dhe të teknologjive të kontrollit të garantimit të cilësisë që do të përdoren dhe të ndërhyrjeve sistematike që do të ndërmerren;
- të shqyrtimeve dhe të provave të bëra para, gjatë dhe pas prodhimit duke treguar shpeshësinë me të cilën mendohet të kryhen;
- të mjeteve për kontrollin e arritjes së cilësisë të kërkuar të pajisjes dhe funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë.

3.3.3 Organizmi shqyrton sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i plotëson kërkesat e pikës 3.3.2. Ai prezumon, në përputhje me këto kërkesa, sistemet e cilësisë që zbatojnë standardet e harmonizuara përkatëse. Ai i njofton vendimin e tij prodhuesit, ndërsa, kur organizmi është i notifikuar, informon edhe organizmat e tjerë të notifikuar. Njoftimi i prodhuesit përmban konkluzionet e shqyrtimit, emrin dhe adresën e organizmit dhe vendimin e vlerësimit të motivuar për pajisjet në fjalë.

3.3.4 Prodhuesi mban të informuar organizmin, që ka miratuar sistemin e cilësisë përse i përket çfarëdo adaptimi të sistemit të cilësisë i bërë i nevojshëm, p.sh. nga teknologjia e re dhe nga konceptet e reja të cilësisë.

Organizmi shqyrton modifikimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i cilësisë i modifikuar është në përputhje me dispozitat përkatëse apo nëse është i nevojshëm një vlerësim i ri. Ai i njofton vendimin e tij prodhuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e kontrollit dhe vendimin e vlerësimit të motivuar.

3.3.5 Organizmi i notifikuar që tërheq miratimin e një sistemi të cilësisë, informon organizmat e tjerë të notifikuar, duke motivuar vendimin e tij.

3.4 Mbikëqyrja

3.4.1 Qëllimi i mbikëqyrjes është të garantojë që prodhuesi plotëson pa gabime detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë së garantuar.

3.4.2 Prodhuesi duhet të lejojë hyrjen, për qëllim inspektimi, të organizmit të miratuar ose organizmit të notifikuar në lokalet e prodhimit, kontrollit, kolaudit dhe depozitimit dhe jep të gjitha informacionet e nevojshme e në mënyrë të veçantë:

- dokumentacionin mbi sistemin e cilësisë;
- regjistrimet e kryera në fushën e cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat mbi provat, të dhënat e tarimit, raportet mbi kualifikimin e personelit të ngarkuar etj.

3.4.3 Organizmi kryen kontrolle të paktën një herë në çdo dy vjet për t'u siguruar që prodhuesi mban dhe zbaton sistemin e cilësisë së miratuar dhe i dërgon prodhuesit një raport mbi kontrollin e kryer.

3.4.4 Veç kësaj organizmi mund të bëjë vizita të paparalajmëruara tek prodhuesi. Gjatë këtyre vizitave organizmi mund të kryejë ose të bëjë të kryhen prova mbi pajisjet. Ai i lëshon prodhuesit një raport të vizitës dhe nëse është e nevojshme një raport të provës.

3.4.5 Prodhuesi mban në dispozicion raportin e organizmit për ta paraqitur kur të kërkohet nga organet e shtetit.

4. Deklarimi i konformitetit me tipin (Garancia e cilësisë së produktit)

4.1 Deklarimi i konformitetit me tipin (garancia e cilësisë së produktit) është procedura me të cilën prodhuesi që plotëson detyrimet sipas pikës 4.2 deklaron që pajisjet në fjalë përputhen me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit të tipit dhe kënaqin kërkesat përkatëse të parashtruara në këtë rregullore. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar i stabilizuar në komunitet duhet të vendosë shenjën CE mbi çdo pajisje të destinuar për në tregun komunitar dhe përpilon me shkrim një deklaratë konformiteti. Kjo deklaratë konformiteti i përket një ose më shumë pajisjeve dhe ruhet nga prodhuesi. Shenja CE duhet të pasohet nga numri i identifikimit të organizmit të notifikuar përgjegjës për mbikëqyrjen CE.

4.2 Prodhuesi zbaton një sistem cilësie të miratuar për inspektimin përfundimtar të pajisjeve dhe për provat, ashtu siç specifikohet në pikën 4.3 dhe i nënshtrohet kontrollit të specifikuar në pikën 4.4.

4.3 Sistemi i cilësisë

4.3.1 Në kuadrin e kësaj procedure prodhuesi i paraqet një kërkesë për miratimin e sistemit të tij të cilësisë për pajisjet në fjalë, organizmit të miratuar ose organizmit të notifikuar të zgjedhur nga ai vetë.

Kërkesa përmban:

- dokumentacionin lidhur me sistemin e cilësisë;
- marrjen përsipër të detyrimeve që vijnë nga sistemi i cilësisë së miratuar;
- marrjen përsipër mbajtjen të pandryshuar të përshtatshmërisë dhe të efektivitetit të sistemit të cilësisë së miratuar;
- dokumentacionin lidhur me tipin e miratuar dhe një kopje të certifikatës së shqyrtimit të tipit.

4.3.2 Në kuadrin e sistemit të cilësisë, secila pajisje shqyrtohet dhe i kryhen provat e duhura, të përcaktuara ose në standardet përkatëse sipas nenit 5, ose prova të barasvlefshme, me qëllim që të verifikohet konformiteti me kërkesat thelbësore përkatëse të parashtruara në këtë rregullore.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe masat e adaptuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e masave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Ky dokumentacion për sistemin e cilësisë duhet të parashtrojë një kuptim të saktë të programeve, të planeve, të manualeve dhe të regjistrimeve lidhur me cilësinë.

Dokumentacioni mbi sistemin e cilësisë duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë një përshkrim të saktë:

- të objektivave të cilësisë, të organikës, të përgjegjësisë të kuadrove dhe fuqive të tyre përsa i përket cilësisë së pajisjeve;

- të kontrolleve dhe provave që duhen të kryhen pas prodhimit;

- të mjeteve për të verifikuar funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë.

4.3.3 Organizmi shqyrton dhe vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar, nëse ai plotëson kërkesat e pikës 4.3.2. Ai prezumon në përputhje me këto kërkesa sistemet e cilësisë që zbatojnë standardin përkatës të harmonizuar. Ai ia bën të njohur vendimin e tij prodhuesit, organizmi i notifikuar njofton organizmat e tjerë të notifikuar. Njoftimi për prodhuesin përmban konkluzionet e shqyrtimit, emrin dhe adresën e organizmit të miratuar ose të organizmit të notifikuar dhe vendimin e vlerësimit për pajisjet në fjalë, të motivuar.

4.3.4 Prodhuesi mban të informuar organizmin që ka miratuar sistemin e cilësisë mbi çfarëdo adaptimi të sistemit i bërë i nevojshëm, p.sh. nga teknologjitë e reja dhe nga konceptet e reja të cilësisë.

Organizmi shqyrton propozimet dhe vendos nëse sistemi i cilësisë i modifikuar përputhet me dispozitat përkatëse apo është i nevojshëm një vlerësim i ri. Ai i njofton vendimin e vet prodhuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e kontrollit dhe vendimin e vlerësimit të motivuar.

4.3.5 Organizmi i notifikuar që tërheq miratimin e një sistemi cilësie informon organizmat e tjerë të notifikuar duke motivuar vendimin e vet.

4.4 Mbikëqyrja

4.4.1 Qëllimi i mbikëqyrjes është të garantojë që prodhuesi të plotësojë pa gabime detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë së miratuar.

4.4.2 Prodhuesi duhet të lejojë hyrjen, për qëllim inspektimi, të organizmit, në lokalet e inspektimit, kolaudimit dhe depozitimit dhe jep të gjitha informacionet e nevojshme në mënyrë të veçantë:

- dokumentacionin mbi sistemin e cilësisë;

- regjistrimet e kryera në lidhje me cilësinë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e tarimit, raportet mbi kualifikimin e personelit të ngarkuar etj.

4.4.3 Organizmi kryen një inspektim të paktën një herë në çdo dy vjet për t'u siguruar që prodhuesi mban dhe zbaton sistemin e cilësisë së miratuar dhe i dërgon prodhuesit një raport mbi inspektimin e kryer.

4.4.4 Veç kësaj organizmi mund të bëjë vizita të paparalajmëruara tek prodhuesi. Gjatë këtyre vizitave organizmi mund të kryejë ose të bëjë të kryhen vëniet në provë të pajisjeve. Ai i lëshon prodhuesit një raport të vizitës dhe nëse është i nevojshëm një raport mbi inspektimin.

4.4.5 Prodhuesi mban në dispozicion raportin e organizmit për ta paraqitur kur kërkohet nga organet shtetërore.

5. Verifikimi

5.1. Verifikimi është procedura me anë të së cilës prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, i stabilizuar në komunitet sigurohet dhe deklaron se pajisjet që i nënshtrohen dispozitave të pikës 3, janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit të tipit dhe kënaq kërkesat e këtij ligji të zbatueshme në to.

5.2 Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, i stabilizuar në komunitet duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme, me qëllim që procesi i prodhimit të sigurojë konformitetin me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit të tipit dhe me kërkesat e këtij vendimi të zbatueshme në to. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, i stabilizuar në komunitet duhet të vendosë shenjën CE në çdo pajisje të destinuar për tregun komunitar dhe të përpilojë me shkrim një deklaratë konformiteti. Deklarata e konformitetit mund të mbulojë një ose më shumë pajisje dhe duhet të ruhet nga prodhuesi

ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, i stabilizuar në komunitet.

5.3 Organizmi i miratuar ose organizmi i notifikuar kryen shqyrtimet dhe provat e duhura, me qëllim që të kontrollohet konformiteti i pajisjes me kërkesat e këtij vendimi duke shqyrtuar dhe provuar secilën pajisje, siç specifikohet në pikën 5.4 ose duke shqyrtuar dhe provuar pajisjet mbi bazë statistikore, siç specifikohet në pikën 5.5 sipas zgjedhjes së prodhuesit.

5.4 Verifikimi me anën e kontrollit dhe provës të çdo pajisjeje.

5.4.1 Çdo pajisje, një për një, duhet të shqyrtohet dhe t'i bëhen provat e duhura sipas standardeve përkatëse të referuara në nenin 5 ose prova të barasvlefshme për të verifikuar konformitetin e tyre me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit të tipit dhe me kërkesat e këtij vendimi të zbatueshme për të.

5.4.2 Organizmi duhet të vendosë ose të bëjë të vendoset numri i tij i identifikimit në secilën pajisje dhe përpilon një certifikatë të shkruar konformiteti lidhur me provat e kryera. Certifikata e konformitetit mund të mbulojë një ose më shumë pajisje.

5.4.3 Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të sigurojë që është në gjendje të paraqesë, sipas kërkesës, certifikatën e konformitetit të organizmit.

5.5 Verifikimi statistikor

5.5.1 Prodhuesi duhet të paraqesë pajisjet e prodhuara në formën e partive të njëtrajtshme dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme që procesi i prodhimit të sigurojë njëtrajtshmërinë e çdo partie të prodhuar.

5.5.2 Kontrolli statistikor bëhet si vijon:

Pajisjet i nënshtrohen kontrollit statistikor sipas përkatësisë. Ato grupohen në parti të identifikueshme të përbëra nga njësi të të njëjtit model të prodhuara në të njëjtat kushte. Partia shqyrtohet në intervale të papërcaktuara. Pajisjet që përbëjnë një kampion shqyrtohen individualisht dhe u bëhen provat e duhura, siç përcaktohet në standardet e nenit 5 ose prova të barasvlefshme për të përcaktuar, nëse partia duhet të pranohet ose të refuzohet. Zbatohet një sistem për zgjidhje kampionësh me karakteristikat që vijojnë:

- nivel cilësie që t'i përgjigjet probabilitetit të pranimi prej 95 për qind me një përqindje moskonformiteti ndërmjet 0.5 dhe 1.5 përqindëshit;

- cilësi kufitare që i përgjigjet probabilitetit të pranimi prej 95 për qind me një përqindje moskonformiteti ndërmjet 5 dhe 10 përqindëshit.

5.5.3 Kur partitë pranohen, organizmi duhet të vendosë ose të bëjë të vendoset numri i vet i identifikimit dhe të hartojë një certifikatë të shkruar konformiteti lidhur me provat e kryera. Të gjitha pajisjet e partisë mund të futen në treg, përjashtuar ato produkte të kampionit të provës që rezultojnë jo në konformitet.

Kur një parti nuk pranohet, organizmi duhet të marrë masat e duhura për të parandaluar futjen në treg të kësaj partie. Në rast mospranimi të shpeshtë të partive organizmi mund të pezullojë verifikimin statistikor.

Prodhuesi, nën përgjegjësinë e organizmit, mund të vendosë numrin e identifikimit të kësaj të fundit, gjatë procesit të prodhimit.

5.5.4 Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të sigurojë që ai është në gjendje të paraqesë certifikatën e konformitetit të organizmit, nëse i kërkohet.

6. Verifikimi i një produkti të vetëm

6.1 Verifikimi i një produkti të vetëm është procedura me të cilën prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, i stabilizuar në komunitet sigurohet dhe deklaron se pajisja së cilës i është lëshuar certifikata sipas pikës 2, është konform me kërkesat e këtij vendimi që ka lidhje me të. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar harton një deklaratë konformiteti me shkrim, që duhet ta ruajë dhe mbi pajisjet e destinuara për në tregun komunitar vendos shënimin CE.

6.2 Organizmi i miratuar ose organizmi i notifikuar duhet të shqyrtojë pajisjen dhe t'i kryejë provat e duhura, duke pasur parasysh dokumentacionin e projektimit për të siguruar konformitetin e tij me kërkesat thelbësore të këtij vendimi. Organizmi duhet të vendosë ose të bëjë të vendoset numri i tij i identifikimit mbi pajisjen e miratuar dhe të hartojë një certifikatë të shkruar të konformitetit lidhur me provat e kryera.

6.3 Synimi i dokumentacionit teknik, lidhur me projektin e pajisjes të referuar në lidhjen IV, është të bëjë të mundur vlerësimin e konformitetit me kërkesat e këtij vendimi dhe që projekti, prodhimi dhe funksionimi i pajisjes të kuptohen. Dokumentacioni i projektit, i referuar në lidhjen IV

duhet të bëhet i disponueshëm për organizmin.

6.4 Nëse organizmi e quan të nevojshëm, shqyrtimet dhe provat mund të kryhen pas instalimit të pajisjes.

6.5 Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të sigurojë që është në gjendje t'i paraqesë, kur t'i kërkohen, certifikatat e konformitetit të organizmit të miratuar ose të notifikuar.

LIDHJA III SHËNIMI CE I KONFORMITETIT DHE MBISHKRIME

1. Shënimi CE i konformitetit përbëhet nga inicialet “CE” në paraqitjen e mëposhtme:



Shënimi CE duhet të pasohet nga numri i identifikimit të organizmit të notifikuar të angazhuar në fazën e kontrollit të prodhimit.

2. Pajisja ose pllaka e saj e të dhënave duhet të kenë shënimin CE së bashku me mbishkrimet në vijim:

- a) emrin ose simbolin e identifikimit të prodhuesit;
- b) emërtimin tregtar të pajisjes;
- c) tipin e ushqimit elektrik, nëse përdor;
- d) kategorinë e pajisjes;
- e) dy shifrat e fundit të vitit në të cilin është vendosur shënimi CE.

Informacion plotësues për instalimin mund të jepet në përshtatje me natyrën e pajisjes.

3. Nëse shënimi CE zvogëlohet ose zmadhohet, duhet të respektohen përmasat e vizatimit të shkallëzuar të dhëna më lart. Përbërësit e ndryshëm të shënimit CE duhet të kenë kryesisht të njëjtën përmasë vertikale që nuk mund të jetë më e vogël se 5 mm.

LIDHJA IV DOKUMENTACIONI LIDHUR ME PROJEKTIN

Dokumentacioni lidhur me projektin duhet të përmbajë informacionet që vijojnë, kur këto janë të nevojshme për organizmin e miratuar ose organizmin e notifikuar:

- një përshkrim të përgjithshëm të pajisjes;
- projektin e përgjithshëm, si dhe skemat dhe vizatimet e prodhimit të pjesëve përbërëse, nyjeve, qarqeve etj.;
- përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar vizatimet dhe skemat e mësipërme duke përfshirë përshkrimin e funksionimit;
- një listë të standardeve të referuara në nenin 5 të zbatuara plotësisht ose pjesërisht dhe përshkrimin e zgjidhjeve të adaptuara për të kënaqur kërkesat thelbësore në rastet kur nuk janë zbatuar standardet sipas nenin 5;
- raportet mbi provat e kryera;
- manualët për instalimin dhe për përdorimin.

Po të jetë e nevojshme dokumentacioni lidhur me projektin përmban elementet që vijojnë:

- dëshmitë lidhur me aparaturat e përfshira në pajisje;
- dëshmitë dhe certifikatat lidhur me metodat e prodhimit, si dhe të inspektimit ose të kontrollit të pajisjes;
- çfarëdo dokumenti tjetër që i bën të mundur organizmit të miratuar ose të notifikuar të

përmirësojë vlerësimin e tij.

LIDHJA V
KRITERET MINIMALE PËR VLERËSIMIN E ORGANIZMAVE TË MIRATUAR
DHE TË NOTIFIKUAR

Organizmat e miratuar nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe organizmat e notifikuar të shteteve anëtare të Bashkimit Europian duhet të kënaqin kërkesat minimale që vijojnë:

- disponimin e personelit dhe të instrumenteve dhe pajisjeve të nevojshme,
- kompetencë teknike dhe tërësi profesionale të personelit,
- pavarësi të personelit kundrejt mjediseve, grupeve ose personave të interesuar drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt për pajisjet në kryerjen e provave, në përgatitjen e raporteve, në lëshimin e certifikatave dhe në kryerjen e kontrolleve të parashikuara në këtë vendim,
- respektim të sekretit profesional,
- kontratë sigurimi për përgjegjësinë civile, përveç rastit kur kjo përgjegjësi mbështetur në ligj, mbulohet nga shteti.

Përputhja me dy pikat e para verifikohet rregullisht nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës me organizma të caktuar me akte ligjore dhe nënligjore.

V E N D I M
Nr.430, datë 26.6.2003

PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR.74, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR KALIMIN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, TË ZYRAVE TË NDËRMARRJES
“MAKINAIMPEKS”, ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE
NACIONALÇLIRIMTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 dhe 124 të ligjit nr.8485, datë 27.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Revokimin e vendimit nr.74, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përdorim, pa shpërblim, të zyrave të ndërmarrjes “Makinaimpeks”, Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.431, datë 26.6.2003

PËR NJËSITË LIGJORE TË MATJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 3 të ligjit nr.8996, datë 30.1.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Ministritë, institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor, personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, detyrohen të përdorin njësitë ligjore të matjes.

Njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Matjes SI janë:

a) Për gjatësinë: metri (m), i cili është i barabartë me gjatësinë e largësisë së përshkruar nga drita në boshllëk, gjatë një kohe prej $1/299\,792\,458$ të sekondës.

b) Për masën: kilogrami (kg), i cili është i barabartë me masën e prototipit ndërkombëtar të kilogramit.

c) Për kohën: sekonda (s), e cila është e barabartë me kohëzgjatjen e $9\,192\,631\,770$ periodave të rrezatimit, që i përgjigjet kalimit ndërmjet dy niveleve superfundore të gjendjes themelore të atomit të Ceziumit ^{133}Cs .

ç) Për intensitetin e rrymës elektrike: amperi (A), i cili është i barabartë me intensitetin e një rryme të pandryshueshme, që duke kaluar nëpër dy përcjellës drejtvizorë e paralelë, me gjatësi të pafundme e prerje tërthore të papërfillshme dhe të vendosur në një largësi 1 m në boshllëk, bën që të bashkëveprojnë ndërmjet tyre me një forcë $2 \cdot 10^{-7}$ njuton për çdo metër gjatësi.

d) Për temperaturën termodinamike: kelvin (K), i cili është i barabartë me $1/273,16$ -tën pjesë të temperaturës termodinamike të pikës trefishe të ujit.

dh) Për sasinë e lëndës: moli, i cili është i barabartë me sasinë e lëndës së një sistemi, që përmban aq njësi elementare sa atome ka në $0,012\text{ kg}$ të lëndës së karbonit ^{12}C . Kur përdoret moli njësitë elementare duhet të specifikohen në atome, molekula, elektrone, pjesëza të tjera ose grupime të specifikuar të këtyre pjesëzave.

e) Për intensitetin e dritës: kandela (cd), e cila është e barabartë me intensitetin e dritës së një burimi, që lëshon në një drejtim të dhënë një rrezatim njëngjyrësh, me frekuencë $540 \cdot 10^{12}$ herz dhe me një intensitet energjetik $1/683$ wat për steradian, në këtë drejtim.

Madhësia, emri dhe simboli i njësive bazë SI jepen në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Njësitë plotësuese të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI janë:

a) Për këndin plan: radiani (rad), i cili është i barabartë me këndin plan, që ka kulmin në qendrën e një rrethi dhe pret në perimetrin e tij një hark me gjatësi sa rrezja e rrethit.

b) Për këndin e ngurtë: steradiani (sr), i cili është i barabartë me këndin e ngushtë, që ka kulmin në qendrën e një sferë dhe pret në sipërfaqen e saj një syprinë të barabartë me atë të një katrori, që ka gjatësinë e brinjëve sa rrezja e sferës.

Njësitë e rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI formohen nga njësitë bazë, nëpërmjet shprehjeve algjebrike, që lidhin madhësitë korresponduese.

a) Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI, të cilat shprehen vetëm nga njësitë bazë të këtij sistemi matjeje, jepen në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI, të cilat shprehen me emra dhe simbole të veçanta, jepen në tabelën nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI, të cilat shprehen nga kombinimi i disa njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI me emra dhe simbole të veçanta, jepen në tabelën nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Sistemi Ndërkombëtar i Matjeve SI shpreh shumëfishat dhe nënfishat dhjetorë të njësive të matjeve, me ndihmën e parashtesave. Faktori i fuqisë, emri dhe simboli i parashtesave të njësive të matjes të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI jepen në tabelën nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Madhësia, njësia, simboli dhe vlera në njësi SI, i njësive të pranuar për t'u përdorur nga Sistemi Ndërkombëtar i Matjeve SI, jepen në tabelën nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Madhësia, njësia, simboli, përkufizimi dhe vlera në njësi SI, i njësive matëse, të pranuar për përdorim nga Sistemi Ndërkombëtar i Matjeve SI, vlera e të cilave është përcaktuar eksperimentalisht, jepen në tabelën nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Rregullat për përdorimin e drejtë të njësive të matjes të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive SI janë:

a) Çdo madhësi në sistemin ndërkombëtar SI ka një njësi të vetme, ndërsa e anasjellta nuk është e vërtetë.

b) Vlerat e madhësive, të quajtura pa përmasa, shprehen vetëm me numra dhe paraqesin raportin e dy madhësive të së njëjtës natyrë.

c) Simbolet e njësive shkruhen me shkronja latine dhe në përgjithësi, me shkronja të vogla.

Në rastet kur emri i njësisë rrjedh nga një emër i përveçëm, shkronja e parë e simbolit shkruhet me shkronjë të madhe, Pa (paskal), A (amper) etj.

ç) Emri i plotë i një njësie shkruhet me shkronjë të vogël.

d) Simbolet e njësive mbeten të pandryshuara, kur vlera e madhësisë ndryshon nga njësia.

dh) Pas simbolit të njësisë nuk vihet pikë, me përjashtim të rasteve kur ndodhet në fund të fjalisë.

e) Nëse një njësi shoqërohet me madhësi relative, ajo tregohet vetëm me simbolin e vendosur prapa vlerës numerike.

ë) Produkti i dy ose më shumë njësive shënohet me njërën nga mënyrat e mëposhtme: $N \cdot m$ ose $N \text{ m}$.

f) Kur një njësi e rrjedhur formohet nga pjesëtimi i dy njësive, përdoret një vijë e pjerrët (/), një vijë horizontale ose eksponente negative (m/s ose m ose $m \cdot s^{-1}$).

g) Asnjëherë nuk përdoret në një rresht më shumë se një vijë e pjerrët, me përjashtim të rastit kur vendosen kllapat (m/s ose $m \cdot s^{-2}$, por jo $m/s/s$).

gj) Shumëfishat dhe nënfishat e njësive së masës formohen nga bashkimi i parashtesave me fjalën “gram”, simboli i të cilit është g ($10^{-6} \text{ kg} = 1 \text{ mg}$ dhe jo $10^{-6} \text{ kg} = 1 \mu\text{kg}$).

h) Simbolet e parashtesave shkruhen me shkronja latine, pa largësi ndërmjet simbolit të parashtesës dhe simbolit të njësive.

i) Nuk lejohet të përdoren parashtesa të përbëra, të formuara nga vendosja e shumë parashtesave, si p.sh. : pF dhe jo $\mu\mu\text{F}$ ose ns dhe jo $m\mu\text{s}$.

j) Nuk lejohet të përdoret parashtesa vetëm, pa njësinë.

k) Nëse simbolit të njësive së ngritur në një fuqi i vihet një parashtesë, atëherë kuptohet që edhe parashtesa është e ngritur në atë fuqi, si p.sh. : $1 \text{ cm}^3 = (10^{-2})^3 = 10^{-6} \text{ m}^3$.

l) Nuk lejohet zbatimi i parashtesave SI për njësitë këndore “°”, “’”, “ $^{\circ}$ ”, për njësitë e kohës min, h, d.

Vendimi nr.539, datë 21.12.1992 i Këshillit të Ministrave “Për njësitë ligjore të matjes” dhe aktet e tjera nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Tabela 3. Njësitë e rrjedhura SI me emra dhe simbole të veçantë

Njësitë e rrjedhura SI

Madhësia	Njësia	Simboli	Lidhja me njësitë e tjera SI	Lidhja me njësitë bazë SI
frekuenca	herz	Hz		s^{-1}
forca	njuton	N		$m \cdot kg \cdot s^{-2}$
presioni, trysnia	paskal	Pa	N/m^2	$m^{-1} \cdot kg \cdot s^{-2}$
energji, puna, madhësia e nxehtësisë	xhaul	J	$N \cdot m$	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2}$
fuqia, fluksi radiant	vat	W	J/s	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-3}$
ngarkesa elektrike, madhësia e elektricitetit	kulon	C		$s \cdot A$
diferenca e potencialit elektrik, forca elektromotore	volt	V	W/A	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-3} \cdot A^{-1}$
kapaciteti elektrik	farad	F	C/V	$m^{-2} \cdot kg^{-1} \cdot s^4 \cdot A^2$
rezistenca elektrike	om	Ω	V/A	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-3} \cdot A^{-2}$
përçueshmëria elektrike	siemens	S	A/V	$m^{-2} \cdot kg^{-1} \cdot s^3 \cdot A^2$
fluksi magnetik	weber	Wb	$V \cdot s$	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2} \cdot A^{-1}$
densiteti i fluksit magnetik	tesla	T	Wb/m^2	$kg \cdot s^{-2} \cdot A^{-1}$
induktiviteti	henri	H	Wb/A	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2} \cdot A^{-2}$
fluksi i dritës	lumen	lm	$Cd \cdot sr$	$m^2 \cdot m^{-2} \cdot cd = cd$
ndriçimi	luks	lx	lm/m^2	$m^2 \cdot m^{-4} \cdot cd = m^{-2} \cdot cd$
aktiviteti (i nje berthame radioaktive)	bekerel	Bq		s^{-1}
doza e përthithur, kerma, energjia specifike e (transmetuar)	grei	Gy	J/kg	$m^2 \cdot s^{-2}$
doza ekuivalente	sievert	Sv	J/kg	$m^2 \cdot s^{-2}$
këndi plan	radian	rad		$m \cdot m^{-1} = 1$
këndi i ngurtë	steradian	sr		$m^2 \cdot m^{-2} = 1$

Tabela 4. Njësitë e rjedhura SI emrat SI emrat dhe simbolet e te cilave përfshijnë njësitet e rjedhura SI me emra dhe simbole të veçantë

Njësitë e rjedhura SI

Madhësia	Njësia	Simboli	Lidhja me njësitë bazë SI
viskoziteti dinamik	paskal sekond	Pa. s	$m^{-1} \cdot kg \cdot s^{-1}$
momenti i forcës	njuton metër	N . m	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2}$
tensioni i sipërfaqes	njuton për metër	N/m	$kg \cdot s^{-2}$
shpejtësia këndore	radian për sekondë	rad/s	$m \cdot m^{-1} \cdot s^{-1} = s^{-1}$
nxitimi këndor	radian për sekondë në katror	rad/s ²	$m \cdot m^{-1} \cdot s^{-2} = s^{-2}$
densiteti i fluksit të nxehtësisë shkëlqimi	vat për metër katror	W/m ²	$kg \cdot s^{-3}$
kapaciteti termik, entropia	xhaul për kelvin	J/K	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2} \cdot K^{-1}$
kapaciteti i nxehtësisë specifike entropia specifike	xhaul për kilogram kelvin	J/(kg . K)	$m^2 \cdot s^{-2} K^{-1}$
energji specifike	xhaul për kilogram	J/kg	$m^2 \cdot s^{-2}$
përcjellshmëria termike	vat për metër kelvin	W/(m . K)	$m \cdot kg \cdot s^{-3} \cdot K^{-1}$
densiteti i energjisë	xhaul për metër kub	J/m ³	$m^{-1} \cdot kg \cdot s^{-2}$
tensioni i fushës elektrike	volt për metër	V/m	$m \cdot kg \cdot s^{-3} \cdot A^{-1}$
densiteti i ngarkesës elektrike	kulon për metër kub	C/m ³	$m^{-3} \cdot s \cdot A$
densiteti i fluksit elektrik	kulon për metër katror	C/m ²	$m^{-2} \cdot s \cdot A$
transmetueshmëria elektrike	farad për metër	F/m	$m^{-3} \cdot kg^{-1} \cdot s^4 \cdot A^2$
përshkueshmëria	henri për metër	H/m	$m \cdot kg \cdot s^{-2} \cdot A^{-2}$
energji molare entropia molare	xhaul për mol	J/mol	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2} \cdot mol^{-1}$
kapaciteti i nxehtësisë molare	xhaul për mol kelvin	J/(mol . K)	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2} \cdot K^{-1} \cdot mol^{-1}$
eksponimi (rrezet x dhe gama)	kulon për kilogram	C/kg	$kg^{-1} \cdot s \cdot A$
intensiteti i rrezatimit	vat për steradian	W/sr	$m^4 \cdot m^{-2} \cdot kg \cdot s^{-3} = m^2 \cdot kg \cdot s^{-3}$
fuqia e dozës së përthithur	grei për sekondë	Gy/s	$kg^{-1} \cdot s \cdot A$
ndriçueshmëria	vat për metër katror steradian	W/(m ² sr)	$m^2 \cdot m^{-2} \cdot kg \cdot s^{-3} = kg \cdot s^{-3}$

Tabela Nr.5 Faktori i fuqisë, emri dhe simboli i parashtesave të njësive të matjes SI

Faktor	Emër	Simboli
1 000 000 000 000 000 000 000 000 = 10^{24}	jota	Y
1 000 000 000 000 000 000 000 = 10^{21}	zeta	Z
1 000 000 000 000 000 000 = 10^{18}	eksa	E
1 000 000 000 000 000 = 10^{15}	peta	P
1 000 000 000 000 = 10^{12}	tera	T
1 000 000 000 = 10^9	giga	G
1 000 000 = 10^6	mega	M
1 000 = 10^3	kilo	k
1 00 = 10^2	hekto	h
1 0 = 10^1	deka	da
1 0 = 10^{-1}	dezi	d
1 00 = 10^{-2}	centi	c
1 000 = 10^{-3}	mili	m
1 000 000 = 10^{-6}	mikro	μ
1 000 000 000 = 10^{-9}	nano	n
1 000 000 000 000 = 10^{-12}	piko	p
1 000 000 000 000 000 = 10^{-15}	femto	f
1 000 000 000 000 000 000 = 10^{-18}	ato	a
1 000 000 000 000 000 000 000 = 10^{-21}	zepto	z
1 000 000 000 000 000 000 000 000 = 10^{-24}	jokto	y

Tabela Nr 6. Madhësia, njësia, simboli dhe vlera e njësive të pranuarra për t'u përdorur nga sistemi SI.

Madhësia	Njësia	Simboli	Vlera në njësi SI
koha	minutë	min	1 min = 60 s
	orë	h	1 h = 60 min = 3600 s
	ditë	d	1 d = 24 h
këndi plan	Gradë	°	1° = ($\pi/180$)rad
	Minutë	'	1' = (1/60)° = ($\pi/10800$)rad
	sekondë	"	1" = (1/60)' = ($\pi/648000$)rad
	nygrad	gon	1 gon = ($\pi/200$)rad
volumi	Litër	l, L	1 l = 1 dm ³ = 10 ⁻³ m ³
mase	Ton metrik	t	1 t = 10 ³ kg
trysnia në ajër, lëngje	bar	bar	1 bar = 10 ⁵ Pa

Tabela Nr.7 Madhësia, njësia, simboli, përkufizimi i njësive matëse të pranuar për përdorim nga SI, vlera e të cilave është përcaktuar eksperimentalisht.

Madhësia	Njësia	Simboli	Perkufizimi	Vlera në njësi SI
energji	elektron-volt	eV	1 eV është energji kinetike e një elektroni që kalon në një diferencë potenciali prej 1 V në boshllëk	1 eV = $1.602\ 177\ 33\ (49) \times 10^{-19}\ \text{J}$
masa	njësia atomike e masës	u	1 u është e barabartë me 1/12 e masës së qëndrueshme të një atomi neutral të ^{12}C në gjendje të lire.	1 u = $1.660\ 540\ 2\ (10) \cdot 10^{-27}\ \text{kg}$
gjatësia	njësia astronomike	ua		1 ua = $1.495\ 978\ 706\ 91\ (30) \cdot 10^{11}\ \text{m}$

V E N D I M
Nr.435, datë 26.6.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE TË HERCEGOVINËS PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHAT E ARSIMIT DHE TË SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe të Hercegovinës për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJË-HERCEGOVINËS PËR BASHKËPUNIMIN NË

FUSHAT E ARSIMIT DHE TË SHKENCËS

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës (më poshtë të quajtura “Palë”):

me dëshirën për të nxitur bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës;
të bindur se këto fusha kontribuojnë në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet dy popujve;
duke vepruar në përputhje me dispozitat e Konventës Kulturore Europiane, Aktit Përfundimtar të Konferencës së Helsinkit për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë dhe Kartës së Parisit për një Europë të Re,
kanë vendosur të nënshkruajnë këtë Marrëveshje dhe kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët do të nxisin zhvillimin dhe vendosjen e marrëdhënieve të drejtpërdrejta ndërmjet universiteteve dhe institucioneve kërkimore me synim:

- shkëmbimin e teksteve, të kurrikulave, të pajisjeve audio-vizuale, të informacionit të kërkimit shkencor, botimeve dhe të të gjitha llojeve të dokumentacionit përkatës;
- shkëmbimin e anëtarëve të stafit mësimor të universiteteve dhe instituteve teknologjike të tyre, si dhe të studentëve, shkencëtarëve, studiuesve dhe ekspertëve;
- formulimin dhe zbatimin e programeve dhe projekteve të përbashkëta të zhvillimit;
- bashkëpunimin ndërmjet instituteve të kërkimit pedagogjik;
- çdo formë tjetër të bashkëpunimit, për të cilën Palët do të bien dakord.

Neni 2

Palët do të ofrojnë bursa për studime universitare, pasuniversitare dhe kërkimore.

Neni 3

Palët do të identifikojnë fushat për zhvillimin e kërkimeve të përbashkëta shkencore, duke marrë në konsideratë shkëmbimin e studentëve universitarë dhe pasuniversitarë si hap i parë drejt iniciativave të mëtejshme në kuadrin e gjerë të bashkëpunimit në fushën e shkencës dhe të kërkimit.

Neni 4

Palët do të ndihmojnë për të siguruar një pjesëmarrje të gjerë të profesorëve, specialistëve dhe kërkuesve shkencorë në seminarët, simpoziumet ose konferencat ndërkombëtare të organizuara në vendet e tyre respektive, si një mjet që do të kontribuojë për shkëmbimin e rregullt të informacionit ndërmjet Palëve.

Neni 5

Palët do të mbështesin pjesëmarrjen në seminare dhe kurset e trajnimit të gjuhës dhe civilizimit të organizuara nga Pala tjetër.

Neni 6

Palët do të zhvillojnë shkëmbimin e njohurive dhe të eksperiencës në të gjitha nivelet e arsimit. Ato do të bashkëpunojnë në trajnimin e punonjësve që punojnë në fushën e administratës së arsimit dhe institucioneve shkencore.

Neni 7

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet organizatave të rinisë shkollore dhe organizatave joqeveritare (OJQ) në fushën e arsimit ndërmjet dy vendeve. Palët do të shkëmbejnë

informacion dhe eksperiencë për çështjet e rinisë dhe të OJQ-ve përkatëse, duke synuar zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkollore dhe jashtëshkollore, binjakëzimin e shkollave dhe krijimin e një atmosfere miqësore dhe promovimin e paqes.

Neni 8

Palët do të bashkëpunojnë për prezantimin, në secilin vend, të historisë, të gjeografisë, të kulturës dhe ekonomisë së vendit tjetër, veçanërisht në tekstet shkollore. Për këtë qëllim, ato do të ndërmarrin veprime të përbashkëta, si shkëmbimin e materialeve dokumentare dhe ndërmarrjen e një veprimi të përbashkët për tekstet shkollore.

Neni 9

Palët bien dakord për njohjen reciproke të diplomave, të gradave dhe të titujve shkencorë të Palës tjetër, në përputhje me standardet e konventave europiane. Kushtet përkatëse për këtë njohje reciproke do të përfshihen në marrëveshjen e veçantë që do të nënshkruhet ndërmjet Palëve për ekuivalentimin e diplomave, gradave dhe titujve shkencorë.

Neni 10

Me pëlqimin e Palëve, mund të realizohen dhe aktivitete të tjera që janë në përputhje me objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Palët do të krijojnë një komision të përbashkët (të përbërë nga dy ose tre përfaqësues), i cili do të mbledhet në mënyrë alternative çdo vit në Tiranë dhe Sarajevë për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Komiteti do të shqyrtojë çështje që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ai do të përpilojë detajet e programeve të bashkëpunimit, si dhe kushtet e tyre financiare.

Neni 12

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi përkohësisht nga data e nënshkrimit të saj dhe përfundimisht nga data që Palët njoftojnë njëra-tjetrën, për plotësimin e të gjitha kërkesave të nevojshme ligjore të brendshme.

Neni 13

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë 5 (pesë) vjeçare dhe, pas kësaj, do të shtyhet në mënyrë automatike për një periudhë tjetër 5-vjeçare, në qoftë se asnjëra nga Palët nuk e denoncon atë me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike 6 (gjashtë) muaj para afatit të skadimit të çdo periudhe 5 (pesë) vjeçare.

Kjo Marrëveshje u nënshkrua në Sarajevë, më 15 prill 2003 në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

V E N D I M **Nr.436, datë 26.6.2003**

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të nenit 3 të ligjit nr.7663, datë

20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme të pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, pensionet për merita të veçanta, pensionet e posaçme shtetërore, shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, të caktuara në mbështetje të ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të rriten 10 për qind.

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe pensionet e caktuara në mbështetje të paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të rriten 20 për qind.

3. Pensionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.7.2003, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri në datën 30.6.2003 përfshirë edhe këtë datë dhe pensionet e përcaktuara në pikën 2 e këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.7.2003, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri në datë 30.6.2003, përfshirë edhe këtë datë, të rriten përkatësisht 10 për qind dhe 20 për qind.

4. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me datë fillimi nga 1.7.2003 e në vazhdim, të mos caktohen më pak se 6728 lekë në muaj dhe më shumë se 13 455 lekë në muaj.

5. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, të caktuara në mbështetje të paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me datë fillimi nga 1.7.2003 e në vazhdim, të mos caktohen më pak se 2590 lekë në muaj.

6. Rritja e parashikuar nga ky vendim të zbatohet mbi masën që rezulton nga shuma e pensionit, plus shtesat e dhëna sipas neneve 33, 38, 39 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

7. Shtesa mujore, e përfituar në mbështetje të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të rritet 10 për qind.

8. Pensionet e caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”, të rriten 10 për qind.

9. Efektet financiare për vitin 2003 llogariten në shumën 1659 milionë lekë dhe të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

10. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1.7.2003.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.437, datë 26.6.2003

PËR RITJEN E SHITESAVE MUJORE TË PENSIONEVE TË INVALIDITETIT, DHËNË SIPAS VENDIMIT NR. 381, DATË 20.5.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 “PËR STATUSIN E INVALIDIT””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit” dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shtesat mujore mbi pensionet e invaliditetit, si përfitim paaftësie, që u jepen invalidëve, në mbështetje të vendimit nr.381, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave, të rriten 10 për qind.

2. Efektet financiare, në shumën 5 000 000 (pesë milionë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Institutit të Sigurimeve Shoqërore në buxhetin e vitit 2003, zëri “Shpenzime për programe të veçanta”, t’i shtohen 5 milionë lekë. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.438, datë 26.6.2003

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS, PËR
BASHKËPUNIM NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS MBI BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR
KRIMIT

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabineti i Ministrave të Ukrainës, të quajtura më poshtë si “Palë Kontraktuese”:

duke qenë të shqetësuar për rritjen e kriminalitetit, në mënyrë të veçantë të krimit të organizuar;

duke i dhënë rëndësi të madhe bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për sigurinë dhe ruajtjen e ligjit dhe të rendit me qëllim që të luftohen në mënyrë efektive të gjitha llojet e kriminalitetit, në mënyrë të veçantë të krimit të organizuar;

duke u përpjekur për të krijuar rregullat dhe format optimale përsa i përket veprimtarive

operative, ashtu si edhe për të përdorur masa parandaluese nga ana e organizmave të përmendur;
 duke marrë parasysh kërkesën për të mbikëqyrur rregullat e së drejtës ndërkombëtare dhe dispozitat e legjislacionit shtetëror, bazuar në parimet e barazisë, respektit dhe përfitimit reciprok;
 duke dëshiruar përshtatjen e veprimtarive të saj kundër krimit të organizuar ndërkombëtar në lidhje me kushtet aktuale;
 duke nxitur zbatimin e Konventës europiane mbi asistencën e përbashkët në çështjet penale (1959), Konventës europiane për ndalimin e terrorizmit (1977), Konventës mbi pastrimin, kërkimin, bllokimin dhe konfiskimin e produkteve që rrjedhin nga krimi (1990), Konventës europiane mbi ekstradimin (1957) dhe Konventës europiane mbi transferimin e procedurave gjyqësore në çështjet e kriminalitetit (1972),
 kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në përputhje me legjislacionet e tyre shtetërore në sferat e mëposhtme:

- 1) lufta kundër terrorizmit, parandalimi i aktiviteteve që financojnë terrorizmin;
- 2) lufta kundër krimit të organizuar;
- 3) lufta kundër trafikimit të paligjshëm të armëve, municionit, lëndëve plasëse dhe atyre toksike, materialeve dhe teknologjive me përdorim të mundshëm të dyfishtë (ushtarake dhe civile), lëndëve bërthamore dhe burimeve të rrezatimit jonizues;
- 4) lufta kundër trafikimit të paligjshëm të drogave, lëndëve narkotike, lëndëve psikotrope dhe prekursorëve;
- 5) lufta kundër falsifikimit të parave dhe mjeteve të tjera të pagesës, elementeve të sigurisë, dokumenteve financiare, futjes së tyre në qarkullim dhe përdorimit të paligjshëm të tyre;
- 6) lufta kundër krimeve në sferat ekonomike dhe financiare, duke përfshirë krimet që kanë të bëjnë me evazionin fiskal, legalizimin e të ardhurave nga krimi dhe korrupsioni;
- 7) lufta kundër kontrabandës dhe shkeljeve apo kundërvajtjeve në taksimin doganor;
- 8) lufta kundër krimeve ndaj individëve;
- 9) lufta kundër krimeve ndaj pronës;
- 10) lufta kundër krimeve, objektet e të cilave janë vlerat historike dhe kulturore dhe produktet e metaleve dhe mineraleve të çmuara;
- 11) lufta kundër vjedhjeve dhe trafikimit të paligjshëm të mjeteve të transportit;
- 12) lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzimin seksual të tyre;
- 13) lufta kundër migracionit të paligjshëm;
- 14) lufta kundër krimeve në fushën e kibernetikës;
- 15) kërkimi i njerëzve të humbur, identifikimi i personave të panjohur, si dhe identifikimi i kufomave të paidenfikuar;
- 16) kërkimi i personave që dyshohen ose akuzohen për kryerjen e një krimi, ashtu si edhe personave që i shmangen përgjegjësisë për kryerjen e krimit ose shlyerjes së dënimit.

2. Bashkëpunimi i ndërsjellë i Palëve Kontraktuese duhet të kryhet në përputhje me normat e legjislacionit të tyre në fuqi pikësepari në formën:

- 1) e përmbushjes së masave të përmendura në kërkesat dhe të lejuara nga legjislacioni i palës së kërkuar;
- 2) e shkëmbimit të materialeve, informacionit shkencor dhe teknik dhe i rezultateve të ekspertizave;
- 3) e shkëmbimit të informacionit në lidhje me sistemet e regjistrimeve (dokumentimeve) operacionale dhe atyre gjyqësore dhe mundësive për përdorimin e tij;
- 4) e shkëmbimit të përvojës dhe bashkëpunimit në sferën e trajnimit profesional të specialistëve;
- 5) e shkëmbimit të informacionit në lidhje me organizatat kriminale që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të Ukrainës;
- 6) e shkëmbimit të akteve legjislative dhe të akteve të tjera normative të Palëve Kontraktuese, që ndihmojnë në sigurimin e literaturës mësimore dhe rekomandimeve metodologjike;
- 7) e takimeve periodike të përfaqësuesve të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese

për analizimin e bashkëpunimit në të gjitha sferat dhe nivelet;

8) e dhënies së aparaturave të posaçme, që përdoren në luftën kundër krimit.

3. Kërkesat e parashikuara nga kjo Marrëveshje dhe përgjigjet ndaj tyre duhet të bëhen me shkrim. Në rastet urgjente kërkesa mund të bëhet me gojë dhe duhet të konfirmohet pa vonesë me shkrim.

4. Kjo Marrëveshje nuk do të pengojë Palët Kontraktuese për të krijuar dhe zhvilluar forma të tjera bashkëpunimi.

Neni 2

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje janë:

Në Republikën e Shqipërisë:

- Ministria e Rendit Publik,
- Prokuroria e Përgjithshme
- Shërbimi Informativ Shtetëror
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Në Ukrainë:

- Ministria e Punëve të Brendshme
- Prokuroria e Përgjithshme
- Shërbimi i Sigurimit
- Komiteti i Rojës së Kufirit Shtetëror të Ukrainës
- Administrata e Taksave Shtetërore
- Shërbimi Shtetëror i Doganave

1) Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të organizojnë takime të ekspertëve me qëllim vlerësimin e bashkëpunimit dhe përmirësimit të tij.

2) Me qëllim realizimin e dispozitave të Marrëveshjes, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të përfundojnë protokolle shtesë, të cilat do të specifikojnë drejtimit konkrete të bashkëpunimit dhe rrugët e kontakteve.

Neni 3

1. Në përputhje me këtë Marrëveshje respektimi i standardeve ligjore të shtetit të kërkuar është i detyrueshëm në kuadrin e bashkëpunimit.

2. Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve brenda zbulimit të krimeve, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të dërgojnë përfaqësuesit e tyre në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 4

Me qëllim garantimin e konfidencialitetit të të dhënave personale, të cilat janë transferuar reciprokisht në kuadrin e bashkëpunimit të shqyrtuara nga kjo Marrëveshje në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendet e tyre, Palët Kontraktuese do të respektojnë këto kushte:

1. Pala Kontraktuese, e cila merr të dhënat mund t'i përdorë ato vetëm me qëllim dhe sipas kushteve, të përcaktuara nga Pala Kontraktuese që ia dha ato.

2. Pala Kontraktuese, e cila merr të dhënat do të informojë Palën Kontraktuese që i dha ato lidhur me përdorimin e tyre dhe rezultatet e arritura.

3. Të dhënat personale mund t'u dërgohen vetëm autoriteteve shtetërore, përgjegjëse për sigurinë dhe rendin publik. Transferimi i të dhënave organeve të tjera, shtetit të tretë ose personave fizikë dhe juridikë do të lejohet vetëm mbi bazën e marrëveshjes me shkrim të Palës Kontraktuese që i dha ato të dhëna.

4. Pala Kontraktuese, që i dha të dhënat, do të marrë një vendim lidhur me domosdoshmërinë dhe dobinë e dhënies së tyre dhe do të bëjë të interesohet rreth autenticitetit dhe saktësisë së tyre. Përveç kësaj është e nevojshme për t'u ballafaquar me legjislacionin kombëtar të shtetit të Palës tjetër

Kontraktuese që kufizon ose ndalon këtë dorëzim të dhënash. Nëse mësohet se të dhënat e siguruar nuk janë të besueshme ose janë të ndaluara për t'u transferuar, është e nevojshme të informohet Pala Kontraktuese që mori atë informacion. Pala Kontraktuese, që mori informacionin është e detyruar të saktësojë informacionin jo të besueshëm dhe t'i fshijë ato të dhëna që ndalohen për t'u transferuar.

5. Personi, të dhënat personale të të cilit do të jepen ose janë dhënë mbi bazën e kërkesës së atij personi, do të informohet lidhur me transferimin e të dhënave dhe qëllimet e përdorimit të tyre, në rast se kjo gjë lejohet nga legjislacioni kombëtar i të dyja Palëve Kontraktuese.

6. Pala Kontraktuese që jep informacionin do të njoftojë Palën tjetër Kontraktuese në lidhje me kushtet e asgjësimit e atij informacioni, të cilat parashikohen nga normat legjislative të shtetit përkatës. Pavarësisht nga ato kushte, të dhënat personale duhet të asgjësohen kur është e nevojshme.

Neni 5

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të refuzojë plotësisht ose pjesërisht të japë asistencë ose bashkëpunim në formën e dhënies së informacionit ose përmbushjes së akteve (dokumente) të tjera, nëse kjo gjë konsiderohet një kërcënim për sovranitetin, sigurinë ose interesa të tjera themelore të shtetit të saj ose bie ndesh me legjislacionin e saj kombëtar dhe detyrimet në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare.

2. Në rastet e përcaktuara nga pika 1 e këtij neni, Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën menjëherë rreth refuzimit në dhënien e asistencës dhe të shpjegojë arsyet e refuzimit.

Neni 6

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të negociojë rreth kushteve të caktuara për dhënien e asistencës, të cilat janë të detyrueshme për Palën tjetër Kontraktuese.

2. Çdo Palë Kontraktuese do të garantojë fshehtësinë e informacionit të marrë nga Pala tjetër Kontraktuese, nëse ky informacion ka karakter konfidencial në përputhje me normat e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese dhe specifikohet si konfidencial.

3. Materialet, informacioni, teknikat dhe mjetet e tjera të paraqitura mbi bazë të kësaj Marrëveshjeje, mund t'u transferohen shteteve të treta, në qoftë se Pala Kontraktuese që i dha ato konfirmon me shkrim pëlqimin e saj.

4. Çdo shkëmbim i informacionit që është sekret do të kryhet pasi të jetë miratuar dhe hyrë në fuqi Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës, në fushën e mbrojtjes së ndërsjellë të informacionit sekret dhe duhet të plotësojë kërkesat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Çdo Palë Kontraktuese do të përballojë kostot, që lidhen me zbatim e kësaj Marrëveshjeje në territorin e vet, nëse ato nuk arrijnë ndonjë marrëveshje tjetër.

Neni 8

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të bashkëpunojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në mënyrë operative brenda kuadrit të kompetencës së tyre në drejtim të realizimit të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 2.

Neni 9

Në kuadrin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do të përdorin gjuhën shqipe, ukrainase dhe angleze, nëse ato nuk bien dakord për gjuhë tjetër.

Neni 10

Kjo Marrëveshje nuk do të pengojë të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese në

përputhje me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, të firmosura nga ato.

Neni 11

1. Kjo Marrëveshje do të ketë efekt për një periudhë të pacaktuar dhe do të hyjë në fuqi nga data, kur është marrë njoftimi i fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike që të gjitha parakushtet që kërkohen nga legjislacioni ekzistues në vendin e Palës, janë plotësuar për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Mbi bazën e marrëveshjes së ndërsjellë, Palët Kontraktuese mund ta amendojnë me shkrim këtë Marrëveshje. Këto amendamente do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e përmendur në paragrafin 1.

3. Kjo Marrëveshje mund të denoncohet nga secila prej Palëve Kontraktuese. Në këtë rast ajo nuk do të ketë më efekt gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike rreth prishjes së kësaj Marrëveshjeje nga ana e Palës tjetër Kontraktuese.

Bërë në Kiev, më 27 maj 2003 në dy kopje origjinale, secila kopje në gjuhën shqipe, ukrainase dhe angleze, të gjitha tekstet janë autentike. Në rast kontradiktash në interpretim do të merret për bazë teksti në anglisht.

V E N D I M **Nr.440, datë 26.6.2003**

PËR NGRITJEN E AGJENSISË SË URBANIZIMIT TË ZONAVE INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngritjen e Agjencisë së Urbanizimit të Zonave Informale në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

2. Objekt i punës së kësaj Agjencie, të jetë hartimi dhe zbatimi i politikave shtetërore për legalizimin dhe urbanizimin në zonat informale të vendit, për integrimin e tyre në zhvillimin territorial, infrastrukturor dhe të kushteve të jetesës.

3. Realizimi i këtij objekti të bëhet në bazë të propozimeve përkatëse të njësive të qeverisjes vendore, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë që parashikon ligji nr.8652, datë 31.7.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

4. Agjencia të bashkërendojë punën me ISPU-në për hartimin e studimeve të zonave informale të propozuara nga njësiti përkatës të qeverisjes vendore, në zbatim të vendimit nr.722, datë 30.12.1998 të Këshillit të Ministrave “Për rregulloren urbanistike”.

5. Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, në numrin e përgjithshëm të punonjësve, t’i shtohen 5 (pesë) punonjës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Efektet financiare prej 2 310 000 (dy milionë e treqind e dhjetë mijë) lekësh, si rezultat i krijimit të kësaj Agjencie, deri në fund të vitit 2003, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

7. Në vendimin nr.96, datë 13.2.2003 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin për vitin 2003 të numrit të punonjësve të institucioneve buxhetore”, në listën “Numri i punonjësve për vitin 2003” të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

“6. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit 410”.

8. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PAGAT E PUNONJËSVE TË AGJENCISË

INSTITUCIONI	EMËRTIMI	Nr.Pun.	Kateg.	Paga bazë	Diploma	Vjet.	Paga	5%	Tot.paga	Pag.Sig	Sig.Shoq	Gjith. paga	Gjith. sig	Shuma Pag+Sig
Agjencia Urbanizimit Zonave Informale	Drejtor	1	III-a	74 000	9000	4500	87500	4375	91875	47015	14434	551250	86602	637852
	Specialiste	4	III-b	40000	9000	3600	210400	10520	220920	188060	57734	1325520	346407	1671927
		5					297900	14895	312795	235075	72168	1876770	433008	2309778

V E N D I M
Nr.441, datë 26.6.2003

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.427, DATË 12.9.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NJEHSIMIN E GRADAVE USHTARAKE ME FUNKSIONET
ORGANIKE NË TË GJITHA NIVELET E HIERARKISË SË KOMANDIMIT DHE TË
DREJTIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 24 të ligjit nr.8670, datë 26.10.2000 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë,” me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.427, datë 12.9.2002 të Këshillit të Ministrave, pas numrit rendor 28, shtohen numrat rendorë si më poshtë vijnë:
“ 29. Përfaqësues ushtarak i Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, Gjeneral brigade
30. Zëvendëspërfaqësues ushtarak i Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, kolonel.”.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.443, datë 26.6.2003

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS E TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, INSTITUTIT TË
STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE URBANISTIKE DHE ARKIVIT QENDROR TEKNIK
TË NDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat e caktimit të pagave të punës”, i ndryshuar dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe nivelet e pagave në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Struktura dhe nivelet e pagave në Institutin e Studimeve dhe të Projekttimeve të Urbanistikës të jenë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Struktura dhe nivelet e pagave në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit të jenë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjeve 1, 2, 3, diplomë e shkollës së lartë, është 9 000 (nëntë mijë) lekë.
5. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 2) e lidhjeve 1, 2, 3 jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.
6. Shtesa për kualifikim (kolona 3) e lidhjeve 1, 2, 3 është 0.
7. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjeve 1, 2, 3.
8. Paga për punonjësit e tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve, të

Instituti të Studimeve e Projektmeve të Urbanistikës dhe të Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit të jetë sipas lidhjes II/M “Paga për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, ATSH-së, prefekturave dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar” të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.

9. Vendimi nr.587, datë 5.12.1994 i Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Arkivit Qendror Teknik të Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit”, shfuqizohet.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2003, zëri “Fond page”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

11. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2003.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

Emërtimi	Paga mujore			
	Paga individuale			Shtesa e pozicionit
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
	1	2	3	4
Drejtor i Përgjithshëm i DPUK-së	9 000	2%	0	90 000
Nëndrejtor i Përgjithshëm i DPUK-së	9 000	2%	0	74 000
Drejtor drejtorie	9 000	2%	0	55 000
Shef sektori	9 000	2%	0	40 000
Specialist	9 000	2%	0	20 000

Lidhja nr.2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INSTITUTIT TË STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE TË URBANISTIKËS

Emërtimi	Paga mujore
----------	-------------

		Paga individuale		Shtesa e pozicionit
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
	1	2	3	4
Drejtor i ISPU	9 000	2%	0	74 000
N/Drejtor i ISPU	9 000	2%	0	55 000
Shef sektori	9 000	2%	0	40 000
Përgjegjës grupi	9 000	2%	0	30 000
Specialist	9 000	2%	0	20 000

Lidhja nr.3

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E ARKIVIT TEKNIK TË NDËRTIMIT

Emërtimi	Paga mujore			
		Paga individuale		Shtesa e pozicionit
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
	1	2	3	4
Drejtor i AQTN	9 000	2%	0	74 000
N/Drejtor i AQTN	9 000	2%	0	55 000
Shef sektori	9 000	2%	0	40 000
Specialist	9 000	2%	0	20 000

V E N D I M Nr.444, datë 26.6.2003

PËR RRRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE DHE TË PENSIONEVE DHËNË FAMILJARËVE TË PILOTËVE TË RËNË NË KRYE TË DETYRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 dhe 21 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, si dhe të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “ Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, i ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2003, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 10 për qind.

2. Pensionet familjare të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, i ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2003, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 10 për qind.

3. Efektet financiare në zbatim të pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi llogariten në shumën 98.7 milionë lekë dhe janë programuar në buxhetin e vitit 2003, për sigurimin suplementar të ushtarakëve.

4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.445, datë 26.6.2003

PËR INSPEKTIMIN E PUNËS SË DETARËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.7986, datë 13.9.1995 “Për Inspektoratin Shtetëror të Punës”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Inspektimin e kushteve të punës së personave të punësuar, në çdo detyrë, në anijet detare.
2. Inspektimi të bëhet në anijet, rimorkiatorët e detit dhe anijet e peshkimit, të regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë, si person fizik a juridik, vendas a i huaj, që ka si qëllim transportin e pasagjerëve e të mallrave apo qëllime tregtare.
Bëjnë përjashtim nga ky vendim anijet platforma shpimi ose shfrytëzimi, kur nuk përdoren për lundrim.
3. Të gjitha anijet e regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë, të inspektohen nga Inspektorati Shtetëror i Punës i rrethit përkatës në intervale kohe jo më të gjata se 3- vjeçare edhe, kur është e mundur 1-vjeçare.
4. Inspektorati Shtetëror i Punës të jetë organi që ushtron kontroll për zbatimin e legjislationit të punës në të gjitha mjetet e lundrimit, të përmendura në pikën 2.
5. Inspektorët e punës, të pajisur me dokumentacionin përkatës identifikues, kanë të drejtë:
 - a) të hyjnë në portet detare, në portet e ujërave të brendshme, në bordin e anijes së regjistruar dhe në mjediset e brendshme për inspektim;
 - b) të shqyrtojnë, të kontrollojnë ose të organizojnë anketa, kur e gjykojnë të nevojshme, për t’u siguruar për respektimin e dispozitave ligjore; kur vërejnë shkelje dhe mangësi përcaktojnë detyra për shmangien e tyre;
 - c) të mos lejojnë lëvizjen e mjeteve nga porti, kur vërejnë shkelje të rënda të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë të shëndetit e të jetës së detarëve.
6. Të gjithë personat juridikë a fizikë, sipas paragrafit të parë të pikës 2, përpara paraqitjes së kërkesës për licencim apo rilicencim në Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit dhe në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit të pajisen me vërtetim regjistrimi, të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës së rrethit përkatës.

7. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.446, datë 26.6.2003

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.402, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993
“PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR
DHE TË LIGJIT NR.7870, DATË 13.10 1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të pikës 2 nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Në kapitullin I “Sigurimi i detyrueshëm”, shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Kursantët dhe studentët, për kohën e praktikës mësimore, sigurohen nga punëdhënësi vetëm për aksidentet në punë.”.

2. Në kapitullin II “Shuma bazë e përfitimeve”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1.Në mbështetje të neneve 2, 32, 36 dhe 48 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shuma bazë e përfitimit nga data 1.7.2003 e në vazhdim të jetë 6728 lekë në muaj.”.

- Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Në mbështetje të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 për personat që nuk plotësojnë kushtet për përfitim të masës së pensionit, të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, shuma bazë e përfitimit nga data 1.7.2003 e në vazhdim të jetë 2590 lekë në muaj.”.

3. Në kapitullin III “Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve”, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën nga data 1.7.2003 e në vazhdim të jetë 4 334 lekë. Kontributi minimal mujor sipas degëve të sigurimit të jetë:

	në lekë
- Dega e sigurimit të sëmundjeve.....	83
- Dega e sigurimit të barrëlindjeve.....	238
- Dega e sigurimit të pensioneve.....	3093
- Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale...	52
- Dega e sigurimit të papunësisë.....	517
- Sigurimet shëndetësore.....	351”.

- Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Punëdhënësi derdh kontribute të detyrueshme në masën 41.9 për qind të pagës mujore sipas listëpagesave. Nga data 1.7.2003 e në vazhdim paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të jetë 10 343 lekë, ndërsa paga maksimale të jetë 51 715 lekë.”.

- Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Punëdhënësi privat, i vetëpunësuarit, të vetëpunësuarit në ortakëri, që ushtrojnë veprimtari ekonomike (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2003 e në

vazhdim, të derdhin kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në masën 39.2 për qind të pagës mujore minimale prej 10 343 lekësh.”.

- Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Pjesëtarët e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me punëdhënësit privatë dhe të vetëpunësuarin (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi) duke filluar nga data 1.7.2003 e në vazhdim, të derdhin kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në masën 39.2 për qind të pagës mujore minimale prej 10 343 lekësh.”.

- Në pikën 5 shifra “9 403” zëvendësohet me shifrën “10 343”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2003.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M
Nr.447, datë 26.6.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.551 DATË 7.11.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE DHE GRUPIMIN E NJËSIVE TË
QEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, E PËR CAKTIMIN E KUFIJVE TË
PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.551, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave, në lidhjen nr.4, në nëntitullin “Klasa II” në rreshtin e fundit, para fjalëve “...drejtor drejtorie” shtohet “...II-b...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M
Nr.448, datë 26.6.2003

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.775, DATË 28.10.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 72 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1993 “Për rezervat ujore”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pas pikës 4 të vendimit nr.775, datë 28.10.1996 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, shtohet pika 4.1 me këtë përmbajtje:

“4.1 Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Ujit (KKU) të shpërblehen për çdo pjesëmarrje në mbledhje, me shumën 20 000 (njëzet mijë) lekë. Shpërblimi i anëtarëve të KKU-së të përballohet nga buxhetet e miratuara për çdo institucion përkatës që përfaqësojnë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbardimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 3.7.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë